



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr 8379/Prot

Vlorë, më 15.10 2019

Lënda: Dergimi i Planit Vjetor 2020 dhe Planit Strategjik 2020 - 2022

DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM
MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË

Tiranë

Në zbatim të gërmës ç neni 12, gërmës c neni 14, të Ligjit Nr.114 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, po ju dërgojmë Planin Vjetor 2020 dhe Planin Strategjik 2020 - 2022 të miratuar të Njesisë së Auditimit të Brendshëm, Bashkia Vlorë, së bashku me pasqyrat përkatëse.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!




KRYETAR
Dritan Leli



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

MIRATOHET
KRYETAR

Dritan Leli



Plani Strategjik 2020 - 2022
dhe Plani Vjetor 2020
i Njësisë së Auditimit të Brendshëm

Vlorë, Tetor 2019

Tabela e përmbajtjes

- ✚ **Qëllimi i planit strategjik dhe misioni i NJAB**
 - Qëllimi i planit strategjik
 - Misioni i NJAB
- ✚ **Organizimi i NjAB dhe Kuadri Ligjor**
 - Organizimi i NjAB
 - Kuadri Ligjor
- ✚ **Objektivat strategjike**
- ✚ **Identifikimi i Subjekteve**
- ✚ **Identifikimi i fushave/sistemeve prioritare**
- ✚ **Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve**
- ✚ **Kufizimet e auditimit**
- ✚ **Prioritetet per vitet 1+2**

PLANI VJETOR I NJESISE SE AUDITIMIT TE BRENDSHEM

- ✚ **Zhvillimet aktuale ne NJAB**
- ✚ **Prioritetet per vitin 2020**
- ✚ **Objektivat kryesore të AB për vitin 2020**
- ✚ **Programimi i llojeve te angazhimit**
- ✚ **Planifikimi i kostos per vitin 2020**
- ✚ **Planifikimi i burimeve per vitin 2020**
- ✚ **Planifikimi i nevojave të stafit për trajnim**
- ✚ **Sigurimi i brendshem i cilesise**

⇒ Qëllimi i planit strategjik dhe misioni i NJAB

Qëllimi i planit strategjik

Plani Strategjik “Për veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm” përfaqëson një nga veprimtaritë më të rëndësishme për shërbimin e auditimit të brendshëm dhe është një element i kontrollit të brendshëm, i cili hartohet për të siguruar Titullarin e Bashkisë që të gjithë veprimtaritë dhe operacionet e Bashkisë dhe subjekteve të varësisë së saj mbulohen me auditim nga funksioni i veprimtarisë së auditimit të brendshëm. Hartimi dhe miratimi i planit strategjik është kërkesë e Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe Manualin të Auditimit të Brendshëm dhe përgjegjesi e drejtuesit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm për hartimin dhe dërgimin për miratim tek Titullari i Bashkisë dhe dërgimin për informim në Strukturën Përgjegjëse për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm, në Ministrinë e Financës. Njësia e Auditit të Brendshëm, duke u konsultuar e rënë dakort me menaxhimin lidhur me problemet e kontroleve të brendshme dhe administrimit, synon të zbatojë në mënyrë efektive mbulimin me auditim të veprimtarive kryesore dhe me risk të lartë të përcaktuar në këtë plan. Angazhimet e auditimit të brendshëm në Planin Strategjik janë vlerësuar mbi bazën e nevojave tre vjeçare për auditime, mbi bazën e një rishikimi të përgjithshëm të subjekteve që i nënshtrohen auditimit, identifikimit të sistemeve dhe fushave të veprimtarive mbi bazë risku, si dhe burimet njerezore të planifikuara në dispozicion të Njesisë së Auditit të Brendshëm.

Misioni i NJAB

Misioni i Njesisë së Auditit të Brendshëm është që të ndihmë Titullarin për të arritur objektivat e vendosura për Bashkia Vlorë, nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike duke vlerësuar dhe rekomanduar përmirësimin e frytshmërisë së menaxhimit të riskut dhe proceset e kontrollit të brendshëm, në drejtim të zbatimit të ligjit, rregullave dhe kontroleve të vendosura, vlerësimit të dobisë, frytshmërisë dhe efektivitetit të veprimeve; si dhe dhënien e sigurisë objektive mbi saktësinë dhe besueshmërinë e raporteve financiare dhe raporteve të performancës, të përgatitura nga struktura e menaxhimit.


⇒ Organizimi i NjAB dhe Kuadri Ligjor

Organizimi i NjAB

Në strukturën e Bashkisë Vlorë, Njësia e AB është e krijuar si njësi më vete dhe i raporton direkt Kryetarit të Bashkisë.

Pavarësia funksionale është e garantuar sipas ligjit dhe rregullave në fuqi në fushën e auditimit të brendshëm në sektorin publik. Kjo njësi nuk merr pjesë në asnjë veprimtari tjetër brenda sistemit, me përjashtim të dhënies së këshillave për menaxhimin.

Njësia e Auditimit të Brendshëm ka në strukturë 3 punonjës nga të cilët një përgjegjës dhe dy auditues. Struktura mund të pësojë ndryshime në vartësi të politikave të Bashkisë Vlorë ose të qeverisë për ristrukturimin e administratës publike, pa ndikuar në cënimin e standarteve ndërkombëtare të pranura në fushën e Auditimit të Brendshëm.



Kuadri Ligjor

Njësia e Auditimit të Brendshëm, në Bashkinë Vlorë e ushtronë veprimtarinë e saj audituese në mbështetje të:

- Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;
- Urdhri i Ministrit të Financave nr. 69, datë 29.09.2010 “Për miratimin e Manuali i Auditimit të Brendshëm”;
- VKM nr. 83, datë 3.2.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar me VKM nr.353 datë 11.05.2016.
- Urdhri i Ministrit të Financave nr.86, datë 10.12.2015 “Për miratimin e Kodit të Etikës për Audituesit e Brendshëm në Sektorin Publik”
- Vendimi i Kryetarit të Bashkisë nr.132, datë 31.12.2018 “Për miratimin e strukturës organizative së Bashkisë dhe Institucioneve të varesisë”.
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 152/2013 datë 13.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10294, datë 1.07.2010 “Për Inspektimin Financiar Publik.
- Rregullorja e Brendshme e Bashkisë Vlorë viti 2018
- Aktet e tjera ligjore e nenligjore të sisteme/fushave përkatëse objekti auditimi.

⇒ Objektivat strategjike

1. Të përdorë një metodologji Auditimi mbështetur në standardet e pranura ndërkombëtare të Auditimit dhe praktikave më të mira të NJQHAB/MF.
2. Të rrisë bindjen e titullarit mbi nevojën dhe domosdoshmerinë e veprimtarisë së njësive të Auditimit të Brendshëm, si një veprimtari mbështetëse që e ndihmon në arritjen e objektivave të

vendosura, nëpërmjet përgatitjes dhe realizimit të planit strategjik dhe vjetor të bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, nëpërmjet vlerësimit objektiv të përshtatshmerisë dhe efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, bazuar në gjetjet e konstatuara të cilat kanë pasur apo mund të kenë inpakte negative në arrijtjen e objektivave të Bashkisë Vlorë, si dhe nëpërmjet efektivitetit të rekomandimeve të dhëna për përmirësimin e tyre në të ardhmen, duke mundësuar edhe bindjen të titullareve të subjekteve të audituar për ti realizuar ato.

3. Të rrisë bindjen e titullarëve të subjekteve të audituar, e nevojës dhe domosdoshmërisë së veprimtarisë së auditit të brendshëm si një veprimtari që i ndihmon ato në përmirësimin e proceseve të kontrollit të brendshëm dhe vlerësimit të riskut, e cila do të arrihet duke rekomanduar praktikatat me të mira për krijimin e rregullave dhe procedurave specifike për çdo proces pune në subjektet që ato drejtojnë, sidhe duke përmirësuar edhe praktikatat e sjelljes së rolit të auditit të brendshëm.

⇒ Identifikimi i Subjekteve

Për identifikimin e subjekteve objekt auditimi janë përfshirë të gjitha subjektet që i nënshtrohen auditimit nga Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Vlorë, pavarësisht periudhës se kur do të auditohet për një periudhë 3 vjeçare per vitin 2020, dhe vitet 2021 dhe 2022.

Sipas një analizë të hollësishme për këtë qëllim subjektet që i nënshtrohen auditimit janë si më poshtë:

1. Qendra e Kulturës
2. Qendra e Kulturës (Teatri Petro Marko)
3. Klubi Shumësportësh "Flamurtari"
4. Shtëpia e Foshnjës (fondet e alokuara nga Bashkia)
5. Qendra e Zhvillimit PAK (fondet e alokuara nga Bashkia)
6. Ndërmarrja e Shërbimeve Publike

Bashkia Vlore

- Drejtoria e Finance Buxhetit dhe Kontabilitetit
- Drejtoria e Taksave dhe Tarifave vendore
- Drejtoria e Burimeve Njerëzore
- Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve
- Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit
- Drejtoria Ndihmes dhe Shërbimit Social
- Drejtoria Shendetit Publik dhe Mbrojtjes së Konsumatorit
- Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve
- Drejtoria Juridike
- Drejtoria e Emergjencave Civile
- Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit

Gjithashtu me Reformën Territoriale ne Bashkine Vlore janë transferuar funksionet e mëposhtme:

Arsimi parashkollor/punonjësit jomësimoir
Arsimi i mesëm punonjës jomësimoir
Sektori i pyjeve dhe kullotave
Sektori rrugëve rurale
Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi (MZSH)

⇒ Identifikimi i fushave/sistemeve prioritare

Identifikimi i Sistemeve/fushave prioritare që u nënshtrohen auditimit:

1. Përsubjektet që i nënshtrohen auditimit, brenda strukturës së Bashkisë Vlorë në nivel drejtorie ku përfshihen edhe Njësitë administrative, planifikohen auditime përputhshmerië për vlerësimin e funksionimit sistemit të kontrollit të brendshëm në fushat e veprimtarive dhe aktiviteteve te kryera për çdo strukturë të drejtorisë, në përputhje me funksionet dhe detyrat të përcaktuara në rregulloren e brendshme dhe objektivat e Bashkisë Vlorë, në nivel drejtorie, sektori si: buxhetit, financat, monitorimin e strehimit, ndermarrjeve, prokurimet, zbatimin e kontrateve, shpronësimet, kontrollit të zhvillimit të teritorit, investimet e punëve publike dhe monitorimit etj. si dhe për zbatimin e kompetencave të deleguara nga Njësitë Administrative.

2. Për institucionet dhe ndërmarrjet e varësisë së bashkisë.

- Sistemit kontrollit të brendshëm, fushat e veprimtarive dhe aktiviteteve për çdo strukturë
- Sistemi i menaxhimit buxhetor/plan biznesin dhe realizimin e te ardhurave dhe shpenzimeve, rezultatin ekonomiko-financiar.
- Sistemi i menaxhimit të aseteve.
- Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore dhe pagave
- Sistemi i prokurimeve
- Sistemi i pagesave
- Sistemi i kontabilitetit.

⇒ Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve

Duke ushtruar gjykimin tonë janë përcaktuar fushat të cilat kërkojnë vëmendjen e auditimit. Vlerësimi i riskut është bërë mbi bazën e analizës së faktorëve të cilët kanë mundësinë më të madhe për të shkaktuar një ngjarje të papritur që mund të ketë ndikim në arritjen e objektivave të organizatës dhe natyrisht duke i dhënë prioritet gjithashtu dhe fushave të cilat kanë mundësinë më të lartë për të patur një ndikim negativ nga ndodhja e kësaj ngjarjeje. Më pas janë analizuar sistemet dhe fushat për nga rëndësia, materialiteti, ndryshimi që sjell ekzistenca e faktorit negativ.

Ne identifikimin dhe vlerësimin e riskut do te kemi parasysh vlerësimin e regjistrave te riskut te hartuar per cdo sistem.

Në njësitë e varësisë së Bashkisë Vlorë ku janë identifikuar sistemet vleresimi i riskut si më poshtë:

	S i s t e m e t	Mundesia e ndodhjes	Impakti	Risku total
1	<i>Sistemet Menaxhimit te Burimeve Njerezore</i>	mesem	mesem	mesem
a.	Mospërputhja e kërkesave të vendit të punës me aftësitë dhe eksperiencën e stafi qe sjell nje staf te pa kualifikuar.	ulet	mesem	ulet
b.	Nevoja për trajnimin dhe zhvillimin profesional të stafit dhe mungesa e strategjive në këtë drejtim	mesem	larte	mesem
2	<i>Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit</i>	mesem	larte	mesem
a.	Mosplanifikimi i sakte i zerave te vecante	ulet	mesem	mesem
b.	Mosrealizimi i te ardhurave	mesem	larte	mesem
3	<i>Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar</i>	mesem	mesem	mesem
a.	Saktesia e pasqyrave financiare	mesem	mesem	mesem
b.	Mungesa e iformatizimit të kontabilitetit	larte	mesem	mesem
c.	Rakordimet me sistemin e thesarit	ulet	ulet	ulet
4	<i>Sisitemi i pagesave</i>	ulet	ulet	ulet
a.	Mos-saktesia ne llogaritjene pagaveve dhe kontributeve	ulet	ulet	ulet
b.	Perdorimimi i fondit te vecante	ulet	ulet	ulet
c.	Logaritja e oreve shtese	ulet	mesem	mesem
5	<i>Sistemi i Prokurimeve</i>	ulet	mesem	mesem
a.	Sistemi proçedural	ulet	mesem	mesem
b.	Dokumentimi i procesit	ulet	ulet	ulet
II	<i>Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit</i>			
1.	<i>Mjedisi i kontrollit</i>	lart	mesem	mesem
a.	Mospeputhja e anes profesionale me	lart	mesem	mesem

	vendin e punës			
b.	Cenimi i pavaresise se nenpunesve dhe punonjesve	larte	mesem	mesem
c.	Mos promovimi dhe stimulimi i personelit në mënyrën e duhur	mesem	ulet	ulet
2	<i>Menaxhimi i rrisht</i>	mesem	mesem	mesem
a.	Mos vendosja e qartë e objektivave ne subjektet e vartese	mesem	mesem	mesem
b.	Mos identifikimi, njohja, analiza, trajtimi i rrisht në lidhje me objektivat	lart	mesem	mesem
3	<i>Aktivitetet e kontrollit</i>	lart	mesem	mesem
a.	Përcaktimi i politikave të qarta për përmbushjen e sigurt të objektivave.	lart	mesem	mesem
	Adresimi i rrisht në lidhje me arrijten e objektivave të përcaktuara	lart	mesem	mesem

⇒ Kufizimet e auditimit

Risqet e mundshme te auditimit që mund të pengojnë arrijten e objektivave parashikohen:

- Plotësimi i strukturës me qëllim mbulimin e subjekteve të planifikuara për auditim.
- Aftësitë profesionale, kualifikimi dhe përvoja punës së audituesve që do të rekrutohen.
- Vështirësia ne ndërgjegjësimin e drejtuesve të subjekteve qe auditohen, për rëndësinë dhe rolin

e auditimit te brendshëm si konsulencë dhe mbështetje për vlerësimin dhe përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe arrijten e objektivave

⇒ Prioritetet per vitet 1 + 2

Të ndihmojë titullarin e bashkisë dhe titullarët e subjekteve të vartëse të saj, nëpërmjet kryerjes së auditimeve të llojeve përputhshmerië, financiar, performance dhe të kombinuara, në dhënien e vlerësimit të efektivitetit të përdorimit të fondeve buxhetore, funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, pajtueshmërisë akteve të brendshme e kontratatme legjislacionin, ruajtja e aseteve, si dhe vlerësimi i besueshmërisë dhe plotësisë së informacioneve operative e financiare

PLANI VJETOR I NJESISE SE AUDITIMIT TE BRENDSDHEM

⇒ Zhvillimet aktuale ne NJAB

Duke u bazuar ne programin vjetor te punes dhe planin strategjik, per 9 mujorin e pare te vitit jane audituar:

- Qendra e kultures Teatri "Petro Marko"
- Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve
- Parku urban
- Drejtoria e Ndhimes dhe Sherbimit Social
- Emergjencat Civile
- Drejtora e Pronave Publike dhe Menaxhimit të aseteve

Krahas problematikes se ngritur vihet re se per gjetjet e konstatuara nga audituesit eshte percaktuar plotesisht pergjegjesia. Percaktimi i pergjegjesive ka sjelle efekt pozitiv dhe ne dhenien e propozimeve per uljen e pasojave të mangesive dhe shkeljeve te konstatuara. Angazhimi paresor per njesine e auditit mbeten auditimet e plota dhe me tej sipas nevojës së subjekteve të audituara kryerja e auditimeve tematike, duke shmangur ne maksimumin e mundshm nderhyrjet e paargumentuara ne planet e auditimit. Gjithashtu, kostatohet se një vleresim me real i rikut do te ndikonte pozitivisht për uljen e ndjeshme të shmangieve ne plan. Ne perfundim te misioneve te auditimit, per permiresimin e punes ne cdo institucion vartes ne baze te problematikave jane lene rekomandimet perkatese, te cilat jane pranuar nga drejtuesit e institucioneve.

⇒ **Prioritetet per vitin 2020**

Prioritete e Njesise se Auditimit te Brendshem per vitin 2020 do te jene:

- Vlerësimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit si element i veçantë për një Kontroll të Brendshëm Financiar Publik i aftë shtuar vlere ne cdo subjektin e audituar.
- Kryerja e auditimeve në sistemet kryesore dhe me risk të lartë, rritja e cilësisë së punës audituese për dhënien e rezultateve që shtojnë vlerë;
- Ngritja dhe zhvillimi profesional i burimeve njerëzore, për aftësimin e tyre në ushtrimin e funksioneve, detyrave dhe përgjegjësi të ngarkuara.

⇒ **Objektivat kryesore të AB për vitin 2020**

Objektivat kryesore për vitin 2020 janë:

- Përzgjedhja e subjekteve dhe fushave gjatë planifikimit të auditimeve në:
- Subjekte/ fusha të vlerësuara me risk të lartë.
- Subjekte/ fusha që nuk janë audituar me parë.
- Subjekte/ fushaku ka pasur ndryshime e zhvillime gjatë veprimtarise e tyre.
- Subjekte e fusha të vleresuara me rrisk nga titullaret e drejtorive, apo nga rekomandimet e institucionit të KLSH.
- Rritja e cilësisë dhe e performancës së auditimeve duke shtuar cilësinë e zbulimeve dhe rekomandimeve me qëllim dhënien e impakt në rritje përsa i përket përmirësimit të menaxhimit dhe shtimit të vlerës.

⇒ Programimi i llojeve të angazhimit

Gjate vitit 2020 janë planifikuar të kryhen 9 angazhime auditimi. Nga keto 4 janë auditime kombinuara dhe 5 auditime të perputhshmerise. Subjektet që do të auditohen janë si më poshte:

Qendra e Kultures Teatri

Qendra e zhvillimit PAK(fondi i alokuar nga Bashkia)

Klubi Shumësportesh "Flamurtari"

Bashkia Vlore

- Drejtoria e Financë Buxhetit dhe Kontabilitetit
- Drejtoria e Infrastruktures dhe Zbatimit të Projekteve
- Drejtoria e Shëndetësi Publik dhe Mbrojtjes së konsumatorit
- Drejtoria Burimeve Njerëzore
- Drejtoria Juridike
- Analiza e detyrimeve të prapambetura

⇒ Planifikimi i Kostos për vitin 2020

Nr	BUXHETI I PLANIFIKUAR	
	Treguesit e Kostos së Burimeve Njerëzore të NJAB	Plani
	1	2
1	Buxheti Gjithsej	2.328.000
2	Paga dhe Sig.Shoqërore	2.172.000
3	Shpenzime Udhëtimi & Dieta	156.000
4	Të tjera	
5	Numri i Punonjësve	3
6	Kosto për Person (1/5)	728.000

Pjesën më të madhe të koston së auditimit e zënë shpenzimet për paga dhe sig.shoqërore. Nuk është planifikuar ansje fond për nevojave të tjera që lidhen me proceset e auditimit

⇒ Planifikimi i burimeve për vitin 2020

Planifikimi vjetor i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NJAB për vitin 2020

Nr	BURIMET E PLANIFIKUARA		
	Shpërndarja e Burimeve Njerëzore të NJAB	Ditë për tregues	Përlllogaritja e burimeve
	1	2	3
1	Koha maksimale e vlefshme	780	52 jave*5dite*3 persona
2	Pushime Vjetore	60	20 dite*3persona
3	Dite pushimi (Festa Zyrtare)	51	17 dite* 3 persona
4	Pushime për arsye shëndetësore	30	10 dite*3persona
5	Angazhime në trajnime	24	8 dite *3 persona
6	Angazhime në mbledhje/takime	9	3 dite* 3 persona
7	Rezerva të Planifikuara (të papritura)	15	5 dite * 3 persona
	TOTALI	591	197

➤ Planifikimi i nevojave të stafit për trajnim

Për të arritur një punë sa më efikase stafi i angazhuar me punën audituese duhet të zotërojë aftësitë, kompetencat dhe nivelin e caktuar, të gjitha këto të nevojshme për përmbushjen e detyrave me cilësi të lartë. Ky profesion kërkon që secili prej audituesve të zotërojë një nivel të caktuar të njohurive profesionale që mund të kryejë sa më mirë funksionin e tij.

Nr	TEMATIKA E IDENTIFIKUAR PËR TRAJNIM	Pjesëmarr ës në trajnim	Periudha (gjatë vitit)	Kohezgjatja e trajnimit (në ditë)
a.	1	2	3	4
1	Auditimi i fondeve IPA, (raste studimore)	3	3 mujorin e dyte	1 dite
2	Implementimi dhe zhvillimi i proceduarave të auditimit për të rritur mundësin për të zbuluar mashtrimin, duke përfshirë mbledhjen e të dhënave	3	3 mujorin e dyte	1 dite

➤ **Sigurimi i brendshëm i cilësisë**

Bazuar në procedurat e manualit të auditimit të brendshëm, sigurimi i cilësisë së punës audituese bëhet në të gjitha fazat e auditimit të brendshëm, pa cenuar pavaresinë e audituesit.

Sigurimi i cilësisë është planifikuar të bëhet:

- Nga vete audituesi
- Nga përgjegjësi i grupit
- Nga Përgjegjësi i Njësisë

PERGJEGJESË
Lirika Gayani

